

NEXHAT HAKIU

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1

H 20

POEZI



**NË LULE
N BOLLË**

8/4-1
—
H20

NEXHAT HAKIU

NJË LULE MBOLLA

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

R R E Z È L L I M E . . .

Dritëzat natën sa shumë' i dua,
ato që dora ndëz n'errësirë,
hëna dhe yjet më ndrijnë mua,
po nuk më falin asnjë dëshirë. . .

E dua flakën, por atë flakë
që xixat shkrep përmbi oxhak,
atë që ndrin, lëvrin, luhat,
vërvit shtëllungat përdit' e natë.

Dritëzat rrugës sa më pëlqejnë,
kur natën vonë ato shkëlqejnë,
së njëra-tjetrën po shoqërojnë
dhe presin turnet që t'i ndriçojnë.

Feneri n' arë sa më pëlqen,
kur hije njerzish po më rrëfen
n'ato tarracat, ku po më ndrin,
e s'shuhet dot as me stuhinë.

Por edhe flakën atje në stan,
që ndonse larg po rrezëllin,
sa më pëlqen ta shoh më pranë,
kur afër vathës ndrin bagëtinë.

I dua xixat, që përmbi strall
shkrep këmba e rojes në terr të zi,
kur sy-shqiponjë, plot zulm' e mall,
zemër-debojë, vrren në kufi.

Fishekëzjarret më ngazëllojnë
si lule-xixash në qiell ndriçojnë,
një botë tjetër po më rrëfejnë:
heronjt' e luftës kur përkujtojnë.

E dua dritën që po ndriçon
në çdo tunel, në çdo aksion,
po më e bukur se çfardo dritë:
ngjan nata e jonë që shkrep në ditë...

RAPSODI SHQIPTARE

*«Dy-treqind krena u prenë,
kapedana mbenë shtatë,
gur e dru u lanë me gjak...»*

I

Male, varganë malesh, me thepa, çuka-bigë
ku dhia kacavjerret, mullagën të kafshojë,
te ju tufani ndalet, ju jeni posi digë
e nuk e lini erën që fushat t'i rrafshojë!

Te ju më qepen sytë, në kreshtat maja-thinjur,
me diell e me borë përherë të panginjur,
në rrëzat e stërlashta, me ngjarje, mrekuillira,
ku hidhnin valle «zanat» e brishta dhe të dlira,

Dikur ju keni patur «dragonj» e «shtojzavalle»,
armiqtë nuk ju shkelën, veç sutat e thëllëzat,

te ju topuzi hidhesh e dridhesh si në valle,
rapsodët thurën këngët, legjendat edhe gjëzat! . . .

II

Male, varganë malesh, me thepa, çuka-bigë,
mburoj' e çerdhe shqipesh, gjithmonë ju krenarë,
me lisat tuaj shqipot ndërtuan djep e vig,
i lanë gufat, shpellat, kasollet ngritën n'arë.

Ata nëpër lugina çdo pllajë tok lëruan,
me lak e me shigjetë për gjah i shkelën pyjet,
kopshtijet dhe oborret me gardhe i rrethuan,
betoheshin për bukën, për diellin dhe për yjet.

Pastaj kështjella ngritën, përreth me hone, shpella
dhe kulla me frengji ndërtuan prej graniti,
ku çdo armik u step, se ushta e goditi
e dënk me krer' u mbushën rrëpirat më të thella.

III

Me gërxhe, xhunga, shpella, me zgavra thyer-grryer
nga shekujt me stuhi, o male, ju kam parë,

mbi supet mbani kohën që lar' ju ka dhe lyer,
ja pse ju paska hije të jeni kaq krenarë.

Ish krenaria juaj që shqipen nuk e la
ta ngrente gjetskë çerdhen, me bijt' e arratisur,
megjithse Arbëria me gjak e vrer u la,
te ju kish mbetur zulma, me trimëri stolisur.

Po shpata e Skënderit Torviollit ngadhënoi,
e preu gjysmë-hënë, që varej pors i çafka
dhe arbri pallë-ngjeshur, kur tokat i lëroi,
me plisat delnin bashkë kokalla edhe **kafka**.

Me gjak vaditesh gruri, po hekur hante burri,
me vdekjen matesh trimi dhe lindte prapë jeta
pran' lisit plak filizi pat mbirë si qëkuri,
ju male mbetët prapë: flamuj edhe trumbeta!...

IV

Bajraku gjysmë-hënë valoi me urgji,
kalat' u bënë burgje, me vrer e gjak u lye,
minaret, kumbanorët gjëmuar përsëri,
parajsën me atdheun asqetët s'e shkëmbyen.

Po shqipet te ju, male, folenë prapë ngritën
dhe përsëri ju mbetët kështjella si qëmoti,
këmbanat kot gjëmuar, muezinët kot thërritën,
se kënga e mëmëdheut u bë kushtrim baroti.

* * *

*«O ju male me dëborë
pse s'qani hallet e mia!»*

V

Male, varganë malesh, me harqe dhe me maja,
ju shoh gjithmon' krënarë, me bor' e gjelbërime,
me kodra bukuroshe, me hone dhe me pllaja,
me pyje, me liqene, me shpella dhe burime.

Të thinjur ju qëndroni, me kokën drejt nga qielli,
ndën tokë dhe ndën det ju eshtrat keni shtritur,
në gji dhe majë çukash ju ndrin përherë dielli,
po gjurmat e stërllashta askush s'i ka cfilitur! .

Veç «përënditë» s'duken me gjith ato stolira,
kur «endeshin» lajthishtes me fillade dhe burime,

as robërit e ngratë të fishkur nga mÿnxyra
që faleshin e rronin plot lutje dhe bekime.

Po «divat», «shtojzavallet», «kuçedrat dhjetë krerë»,
«e bukura e dheut» e pse tani nuk janë?
«Peritë» dhe «dragonjtë», «magjirat» për të mjerë,
e pse te ju, o male, as gjurma nuk na lanë?

Dikur në gjirin tuaj dëgjoheshin sëpata,
bërtimat e gjahtarve, sorkadhet kur i vranë,
dhe fyelli në stanarët, që ngritën me lojfata
vathën për bagëtinë, gardhore dhe tëbanë!

Male, varganë malesh, ku s'ecte dot as mushka,
me kulla dhe kështjella, përreth kasolle plot,
te ju për shumë vite kërciti vetëm pushka
për gjakun e hakmarrjes, që fali vrer e lot.

Po trimat te ju, male, më vonë trimëruan
për mëmëdhenë jetën sa shpejt e bënë fli,
armiqtë llahtarisën, me radh' u shpartalluan,
prandaj në shekuj mbetët krenarë si tani!

Ju male prapë pritët shqiponjën krahleshuar
dhe nënën shami-zezë, gji-shterur të uritur,

kur mblidhte ca lëpjeta, me shkarpat e ngarkuar,
ndaj ratë në mendime dhe patët uluritur!..

* * *

*«Në male të Shqipërisë
gjëmon klithma e djalërisë!»*

IV

Male, varganë malesh, të mvrejtur, të menduar,
një hije ju mbulonte, rrënkimet kur dëgjonit,
po krenaria juaj ngushllonte të mjeruar
e tok me ta një Prijës përditë ju kërkonit... .

Me melekuqe, male, gjith leckanjarët rritët,
megjithse në kasolle dëgjohej kolla e thatë,
askurrë nuk u krrusën, rrufetë bashkë pritët,
se ishin pjella juaj si burrat edhe gratë... .

Krahrorin e shqiptarit e bëtë ju si shkëmb,
si shkëmbi që pas shqotës e mori prap shkëlqimin,
prandaj dy herë rob shqiptari nuk u trëmb
nga plagët që kish marrë në luftë me mjerimin.

E kur mjerimi nxiu, u bë dhe më i zi,
se prap' armiq të tjerë pushtuan Shqipërinë,
të rinj edhe të reja, deboj' e zjarr në gji,
te ju, o male, erdhën, luftuan për lirinë. . .

Luftuan partizanët atje ku kish armik,
me thonj edhe me dhëmbë, kur s'kishin më fishekë,
as donin që t'ia dinin për hekur e çelik
dhe suleshin vërtik e vrik porsi shigjetë!

Relike shekullore, muzera të stërlashta,
më ngjani ju përherë në malet shqipëtare
e duke ju soditur, më shtangni që përjashta,
megjithëse gjëmadha, ju mbaheni krenare!

Te ju këndon kumria dhe laskuriqët fshihen,
çdo vit e më të vjetra, po më të forta jeni,
barishtet, cergat, ferrat, çdo herë përtërihen,
po gjurmat e stërlashta kujt do ju ia rrëfeni.

Ja pse, ju male, mbetët: kështjella dhe krenarë,
se çetat partizane, tek ju shpejt tubëzuan,
e kur Partia dha kushtimin çlirimtar,
tek ju e nisën pushkën, Atdheun e çliruan. . .

Tani të tjera zana, me çanta përmbi shpinë,
me kazmën, pushkën, supit kalojnë rrugës re,
në zemër ju gërmojnë, këndojnë edhe dinë
që zoçkat rënë tokës t'i vënë në fole...

Male, varganë malesh, mos u çuditni ju,
se përmbi thepa, çuka po mbin edhe kalliri
edhe filiz' i ri ka zënë mbi kërçu,
se duart tona ndrijnë më tepër nga floriri!

Ja bulëzat e djersës rigojn' e bëhen lumë,
vaditin thatësirën, nuk presin uj' nga qielli,
ato dhe ngricën shkrijnë, dëborën bëjnë shkrumë,
se zemra është zjarr, më zjarr nga vetë dielli!

NATA E PARË E ÇLIRIMIT

Kudo vështron
gërmadha, gropa edhe vandakë,
lyer me gjak...

Veçse
mbi gur e mur, ku çdo flamur
krenar valon,
atje
dëgjohet lehtë: si frushëllon
kjo pala e kuqe në qiellin tonë!

Po qielli sonte nuk paska re,
është' i gëzuar ashtu si ne:
ndriçojnë yjet, llambat, qirinjtë,
flakrijnë pishat porsi flamuj.

Dëgjon
e po vështron

kjo nënë,
një hij' e rëndë i paska rënë.

Rri e vështron,
rri e dëgjon
në prag të portës, sepse atje
për herë të fundit e puthi djalin,
kur mori malin.
Te pragu qe
dhe atëherë
kur zemër-çjerrë
për djalin mori lajmin e zi! . . .

Me cilin nëna ka për t'u pjekur
që pret në prak,
pse picëron dhe sytë flakë?
mos hij' e djalit, e djalit vet
i afërohet nënës së shkretë? . . .

Po dridhet nëna, djali po qesh,
ajo bërtet, te pragu bie,
është' bir' i saj, nuk është hije!
është' djali trim që kur u ndesh
një plagë mori në krahëruar
edhe pastaj me këmb' e duar

na ish zvarritur tinës armikut
dhe kish trokitur te dera e mikut!...
Po lajm' i zi që atëherë
pat ardhur shpejt te nën' e mjerë,
ndaj për së gjalli birin kish qarë!...

Tani ajo porsi e marrë
po qan e qesh, shamin' e gris
shamin e zezë, shenjën e zisë...

Ndërsa i biri, që s'kishte rënë
kaq ngusht' e keq,
e përqafon, kërkon t'i heqë
tmerrin e çastit që e kish zënë,
qesh e i flet: — Jam unë. nënë! —

Qesh nëna qesh
dhe djali qesh,
atje në shesh
me qindra hidhen
te flak' e pishës në valle dridhen...

NËNË E BIR...

I

Si ishe ti,
o nëna ime,
kur s'isha unë?
Një vajz' e mjerë, linjë-arnuar, me xhamadan,
si syt' e ballit të kishte nëna me babanë...

Më vonë si shoqet, u bëre nuse,
po nëna e gjorë
të pat martuar pa një dasmor
edhe për pajë ajo të dha:
zemër e krahë...

Nuse me lecka, pa u stolisur,
nga një kasolle të një kalive
të patën nisur,
Si një jetime, nusezë-flutur,
ti fluturove, pa nusëruar,
Flori i gushës, unazë-ari

Kur ishe vajzë, ashtu dhe nuse,
ditën e bardhë ti nuke e pe! .
dhe ja një natë,
ti nus' e re,
me shtat të zënë, mbete e ve.
U ngjite malit
me shtat të zënë, pushkën ndën gunë.
Në gërxhe, gufa: një jet' e re
nisi për ty...

Si qindra shoqe,
shoqe të gunës e të lëpjetës,
ike pas çetës...
Bashkë me to, me partizanë,
sulmove ti,
kundër armiqvet more nishan...

II

Nga ti, moj nus' e ve,
po partizane,
nga shami-zeza me linjë të kuqe,
linda dhe unë si një burbuqe,
që mezi çeli nëpër tufane...

U bëre nënë se linda unë,
me pushkën mua shpejt më ndërrove,
me partizanët prapë tubëzove



edhe më le,
moj nën' e re,
që të luftoje.
Me pushkën ngrehur, ti po përgjoje
nëpër shkëmbenj
e mbi gjermanë,
moj partizane,
merrje nishan...
Me lule-shtogu dhe qull-mulage, pa bërë naze,
mua më konin,
me krisma pushke dhe me çapraze
që tringëllonin,
dremitja unë
te prehr' i gjyshes, mbështjell me gunë.
O nën' e re,
ti nus' e ve,
o partizane,
dhe të më shihje, nuk do më njihje,
se me xhephane
në krah' e shpinë,
me pushkën ngrehur, si vetëtimë
ike, më le.
O nën' e re,
pa një ninull nga zër' i yt
i mbyllja sytë,
veçse kjo gjyshja më rrinte pranë,
duke kënduar

këngët e marshet, që kish mësuar

partizanë...

Ditët e fundit të luftës sonë

linda dhe unë

porsi ylberi nëpër furtunë,
që sjell me vete kohën e bukur.

KUSH ËSHTE?

Ja përsëri
shtëllunga tymi hedh në tavan,
shfletoj dhe librin që më rri pranë,
me lodhen sytë, po gjumë s'kam,
me ankth pres fundin në këtë «dramë».

Mendja më shkon te gjyshja ime,
gjyshja-mavri,
që pret e pret, dyzet vjet,
birin që mbeti larg në kurbet.
Pret në shtëpi:
djalin e vetëm, babanë tim,
që, kur vdiq nëna, më la jetim!
Ajo pret birin, unë: babanë,
atë që s'njoh,
ndaj shpesh e shoh
fotografinë

dhe ngushëlloj
gjyshe-mavrinë...

Mendoj, mendoj
e prapë lexoj,
më lodhen sytë, po gjumë s'kam,
me ankth pres fundin në këtë «dramë»...

Të gjithë flenë,
fle ime shoqe me dy billonjat,
tek unë vjen
firom' e tyre, prandaj dhe shkronjat
po marrin shpirt,
më flasin çiltas si miq të vjetër,
ma joshin zemrën si askush tjetër!..

Kjo bot' e re, kjo bot' e vjetër
(duke lexuar — duke menduar)
përzihen bashkë, por unë njoh
për veten time dhe për fëmijë
botën e re, këtë që shoh
edhe atë që do të vijë...

Lexoj, mendoj,
po një trokitje tani dëgjoj!

E kush kaq vonë
po më shqetëson?..
Mos është, vallë,
dikush në hall.

— Kush është!?
— ?!
— E kush troket?
— Kush më thërret?

.....
Zë i pa njohur, po mora zemër
dhe portën hap...

Një burr' i thinjur në krahë më kap,
më puth edhe qesh, me përçafon,
i skuqen sytë... një lot lëshon,
i dridhet buza, po nuk flet dot,
habitem unë, ç'të them nuk di,
se më hutoi kjo befasi!

Unë: hì i ftohtë, por ai: prush!
Mezi i fola: — Kush je ti, kush? —
Dëgjoj psherëtimën të thell', të gjatë,
kur belbëzoi: — S'më njeh? Yt' atë! —

I ngula sytë te syt' e tij:
po, po, e njoh: fotografia

përngjante pak me atë fytyrë
dhe tek ai
vetvehten pashë si në pasqyrë,
porse tani
jam un' q'e puth, e përqafoj
e një nga një të gjith' i zgjoj...

Puth gjyshja djalin: i dridhet shtati,
puth nusja vjehrin: si t'ish i jati,
edhe fëmijët me gjum' në sy
në krahë i hidhen në çast të dy,
por unë s'ndjej asgjë tani,
më ngjan si mik, më vjen çudi!...

Gjyshja po flet dhe qesh e qan,
gjer në agim të gjithë pranë
qeshim e flasim, porse babanë
s'e ndjej akoma, çudi — çudi,
veç kur më tha: — Shko, bir, ik fli! —

Kishte aguar
dhe rrez' e parë po përshëndet
një të mërguar,
që tym e mjegull pa në kurbet...

E po të vinte dikush të ne,
qoftë një ças,

kish për të parë, të përquafuar
e me sa gas:
tre breza bashkë, duke kënduar
këngën e re ...

NJË NATË KUR M'U SHUA DRITA...

M'u shua drita
dhe prita, prita...

Nuk më pëlqen tani
ky terr në befasi:
më ngjan se flas me vete,
shëtis në male, dete,
mendoj dhe ëndërroj,
por dritën prap' kërkoj...

Dhe prita kot sa prita
se sonte nuk vjen drita!

Pastaj qirinë ndeza
dhe prapë te tryeza
vazhdova punën time...

Sa më pëlqen kjo flakë,
megjithëse është' e mekur,
sonde më qënka tekur
që un' të bisedoj
me të dhe me një flutur
që po i vjen vërdallë.

Nga puna i shkëputur,
me to përse flas, vallë?

Shoh flakën e qiririt
si pah i lules blirit,
shoh fluturën krahëshkruar
dhe hijen e zmadhuar,
te muri un' i shoh,
po pëshpëris me to...

Vështroj qirinë,
kujtoj voglinë
dhe porosinë
e gjyshes sime, kur fluturën kapa,
edhe nga frika e hodha prapa
ashtu të shtypur edhe të vdekur;
se gjyshja ime aher' më tha
të mos i kap se është' gjyna,

se te çdo flutur, gjyshja psherëtiu,
«na qënka shpirti i një njeriu,
njeriut të vdekur që s'ka si ngjallet,
ndaj vjen si flutur me në të çmallet!»

Kurse im bir tani
natyralist i ri,
në çdo kuti ka futur
nga çdo sojë: një flutur,
edhe me shokët është në garë
të gjejë fluturën që s'është parë...

Shoh flakën e qiririt
si pah i lules blirit,
shoh fluturën krahëshkruar
dhe hijen e zmadhuar
të vetes sime shoh
dhe pëshpëris me to...

Sa shpejt qiriri nis të tretet,
ja flaka e fundit si përpëlitet
dhe hija ime më lart po ngjitet...

U shkri qiriri, pa flakë mbeti
që të më ndrijë,
jeta s'iu dhimbs as pak atij...

Ë lum ata
që kanë rënë
— mendoj me vete —
ata që, duke u djegur vetë,
të tjerëve u falën dritë dhe jetë...

NJË DRITE NË LAGJEN TIME

— Ti, babi, nuk më the
sa yje ka në qiell! —

Voglushja, çamarokja,
tani që ka mësuar
se ç'është numri, rrokja,
më pyet pa pushuar...
Por unë me përtim
nuk e kënaq gjithmonë,
se gjëra pa kuptim
edhe pak si të çuditshme
shpesh herë më kërkon!

Ja, çamarokja prapë
te krahu po më kap:
— Babi, po nuk m'i the,
nuk do të shkoj të fle!

— Sa rreze na shkrep dielli
aq yje ka dhe qielli. —

Po çamarokja buzët përdrodhi,
përgjigja ime sikur e lodhi,
nuk u kënaq,
një numër deshte dhe vetëm kaq.
E kur i thashë — pesqindmiljon —
si me kurrështje shpejt belbëzoi,
nuk pyeti më, veçse shqiptoi:
— Ua, sa shumë! —
E si më puthi, gjyshen ngacmoi,
pastaj shpejtoi në shtrat për gjumë. . .

Por me të shkuar kjo çamarokja,
vendin e saj e zu' nënokja,
nënokja-plakë që pyet më shumë,
vetëm ahëre kur mbesa e saj
është në gjumë,
se pasandaj
ajo e tall, e sjellë vërdallë!

E prapë për natë më duhet mua
të jem i ngeshëm, dua nuk dua,

që t'u përgjigjem si çamarokes
edhe nënokes!

— O bir, më duket, të pyeta mbrëmë,
përse do shkojnë në yje, hënë? —
Po qesh, dëgjoj
se sonte «yjet» e paskan fjalën,
ç't'i them nënokes që gërgërit
dhe çamarokes që pyet për ditë?...

Nënokja sonte sa shpejt gërhinte
dhe çamarokja si shqerra flinte...
Por unë vetëm rri në ballkon,
megjithëse vonë,
qiellin vështroj,
qiellin e bukur e të qëruar...

Ndërsa dritaret rreth meje nxijnë
edhe rrugicat kudo po ndrijnë,
po shoh një dritë plot vezullime,
të vetmen dritë në lagjen time...

Natën dhe vonë,
vetëm me hënë jam në ballkon...

Kjo drit' e vetme, e vetmja dritë
në lagjen time,
ndoshta po ndrit
atë që kthehet, pas një rreziku
e me sa dhimbje nga lindja e parë:
nënë... .

Ja pse atje një nur ka rënë,
se sonte foshnjën vet' e ka larë
e s'ka të ngopur duke e parë,
kur fle si shqerra, kur i jep gji.
Nëna nga gazi pa gjumë rri
e po bën rojë
që ta përgjojë
birin e saj.

Ndoshta kaq vonë
kjo dritë ndrin
për frezatoren që pregatitet
për në uzinë,
se turn' i tretë po e thërret
e në ndërgjegje po i troket,
pa çang' e zë,
kur bota flë...

Kjo drit' e vetme, e vetjma dritë
në lagjen time, ndoshta po ndrit
ndonjë lexuese që herën e parë

lexon romanin dhe duke qarë
e duke qeshur, nga njerëzit tinës,
ndjek ndoshta fatin e heroinës!

Të vetmen dritë duke soditur,
në kanape, siç isha shtritur,
gjumi dhe mua më kish kapitur...

Në ëndër pashë drita në qiell,
ylbere, yje, hënë dhe diell,
shkëndija, flakë edhe vullkan,
male të zjarrtë vargan-vargan
që vezullonin lloj-lloj shkëlqime...
Por mbi të gjitha ajo, ajo:
e vetmja dritë e lagjes sime
më fort ndriçonte mbi gjith' ato!...

DIKUSH NUK FLE

Ndriçojnë yjet,
frushllojnë pyjet...
Me drita — hije
sa paska hije
nat' e beharit!

Fijes së barit,
edhe kallinjve
nata u derdh
nurin e verdhë...

Dritaret ndrijnë,
çatitë nxijnë,
rruga gjëmon,
dikush këndon...

Ënë turnet e natës
normat kalohen
dhe fshatrat tona
po zbukurohen
e po ndriçohen:
duken si yje
fatur në pyjel. . .

Yjet po ndrijnë,
dritaret nxijnë,
të gjithë flenë,
porse Dikush as natën s'fle:
mendon për ne, për ty, Atdhe!

NJË LULE MBOLLA...

Një lule mbolla në një saks,
kur në aksione ne patëm ikur,
ajo ish rritur, se në shtëpi
motra pioniere e kish ujitur...

E mora sot, me sa gëzim,
lulen e bukur, që vet' e mbolla,
u mbush dhe klasa me kundërmim:
Mësues i dashur, për ju e solla!...

E BUKUR NATË...

E bukur nata, dikur e qetë,
dëgjohej vetëm zër' i këndezit,
një hamulitje, një krism' e lehtë,
gjersa të shkrephte yll' i mëngjezit.

Tani kjo natë më ngjan si dita,
s'ka të pushuar zër' i maqinës,
po xixëllojnë, shkrepin në drita
syt' e fabrikës, syt' e uzinës. . .

SI E KALUAM VITIN E RI...

Përreth tryezës, tok me fëmi,
ashtu siç ngjan në çdo shtëpi,
me miqtë bashkë,
jo për bajram dhe as për pashkë,
me sa gëzim e pritëm tok
vitin e ri, si për çdo mot...

Te kënd' i dhomës, pema e stolisur
po nusëronte si nus' e nisur
e duke kqyrë
plot vezullime,
po bisedoja gjith' atë natë
me shokët pranë, me veten time...

Jetën sodis,
jetën e bukur mes shoqërisë,
fëmijët shoh gjith' shend' e verë
porsi burbuqet në pranverë,

atje ku zverdhen rrushi dhe ftoi,
ku kanarina
këngën për jetën nuk e pushoi...

Dritat vështroj
atje te pema e vitit të ri
edhe kujtoj
fshatin e vjetër, fshatin e ri!
kujtoj kandilin që rëgëtiu,
dritën e parë që vezulloi
edhe filizin që shpejtas mbiu
përmbi kërcu edhe mbi shkëmb!

Gjithë kujtimet shkëndi-shkëndi
m'u mblodhën bashkë edhe si rrezë,
sa më ndriçuan tok me fëmi
edhe me miqtë rreth në tryezë...

E kur na gjeti ky vit i ri
të gjithë bashkë të përqaftuar,
nuk di pse mbetëm kaq të gëzuar...
S'na erdhi keq që u paksua
një vit në jetë,
sepse vërtetë

në çastin pamë, si me çudi,
te çdo fëmi
vetveten tonë të përtëritur
edhe të ardhmen sa më të ndritur...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Rrezëllime	3
Rapsodi shqiptare	5
Nata e parë e çlirimit	13
Nënë e bir... ..	16
Kush është?	21
Një natë kur m'u shua drita... ..	26
Një dritë në lagjen time	30
Dikush nuk fle	35
Një lule mbolla... ..	37
E bukur nata... ..	38
Si e kaluam vitin e ri... ..	39